REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:271750
Datë: 26.02.2020
Numri i dokumentit: 00857557

A.nr. 768/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, me zyrtaren ligjore Besë Sylaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, M.G. nga fshati Ll., komuna e Podujevës, të cilën me autorizim e përfaqëson Mahmut Hoti, avokat në Podujevë, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson M.B., për shkak të anulimit aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në mungesë të palës paditëse dhe prani të autorizuarës të palës së paditur, me datë 04.02.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit M.G. nga fshati Ll., komuna e P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, me nr. 03/639/17 të datës 18.04.2017, e protokolluar me datë 19.04.2017, **si e pa bazuar.**

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2020, është mbajtur shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridiko-administrative duke filluar nga ora 10.30, sipas dispozitave të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës se paditur dhe në mungesë të palës së paditëse e cila është ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: Fletë-dërgesa e pranuar, me konfirmim të datës 22.01.2020).

Paditësi M.G., me padinë e ushtruar më datë 28.04.2017, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet aktvendimi i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, me nr. 03/639/17 të datës 18.04.2017, si i pa bazuar.Me tej, thekson se, paditësi nga ana e komunës është shpallur uzurpator dhe ka ushtruar ankesë te Agjencia Kadastrale e Kosovës kundër vendimit të shkallës së parë, ku injëjti

2019:271751

e ka refuzuar me aktvendimin e dt. 18.04.2017, prandaj i pa kënaqur kundër këtij akti kontestuar kërkon nga gjykata që të anuloj vendimin kontestues dhe ti njihet e drejta e regjistrimit te kësaj patundshmërie në regjistrat kadastral me arsyetimin se deri më tani nuk e ka ditur se ngastra kontestuese evidentohet nëemrine KomunëssëPodujevës dhe se shfrytëzues i kësaj patundshmërisë ka qenë prej që ka lindë dhe tënjëjtën e kanë shfrytëzuar prindërit e tij që do tëthotë qe 100 vite.

E autorizuara e të padituërës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar, mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, t'a anulon në tërësi si të pa bazuar, ndërsa t'a lenë në fuqi si të ligjshëm aktvendimin e atakuar nga paditësi.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.02.2020, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i dt. 18.04.2017 me nr. referencë 03/639/17; aktvendimi me nr. 08-466-4 i dt. 06.03.2017 i lëshuar nga Drejtoria për pronë Kadastër dhe Gjeodezi; shkresa e lëshuar nga Komuna e Podujevës e dt. 28.03.2017 me nr. 08/50; formulari për kërkesë apo ankese i dt. 27.03.2017; ankesa e dt. 24.03.201; dëftesa e dt. 27.03.2017; vërtetimi për M.G. i lëshuar nga komuna e Podujevës e dt. 27.03.2017; procesverbali mbi dëgjimin e palëve per prone kadastër dhe gjeodezi i përpiluar me dt. 01.03.2017; Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre e lëshuar nga MMPH e dt.. 27.02.2017; certifikate me nr. 17-5818, i dt. 28.02.2017;procesverbali per konstatim ne vend te ngjarjes i përpiluar me dt. 27.02.2017 dhe konkluzioni me nr. 08-466-4, i dt. 27.02.2017.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve kontestuese komfor nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) – Ligji Nr. 03/L-202, gjykata në bazë të provave të administruara dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **pa bazuar.**

Me aktvendimin e Agjencisë Kadastrale e Kosovës nr.03/639/2017, të datës 18.04.2017, të goditur me padi, është refuzuar ankesa e B., B. dhe M.G., si e pa bazuar. I pa kënaqur me të njëjtin vendim paditësi M.G. ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 28.04.2017, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua Ligjit NR.03/L-154 për Pronësi dhe të Drejtat Tjera Sendore, përkatësisht nenit 18 paragrafi 1 me te cilin është përcaktuar që "Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të

tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti. "

Gjykata, nga shkresat e lëndës vëren se, sipas detyrës zyrtare komuna e Podujevës,Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Pronë, ka iniciuar procedurë administrative për uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shoqërore, kundër tani paditësit M.G.nga fshati Ll., komuna e Podujevës dhe me aktvendimin e datës 06.03.2017,me nr. 08-466-4, ka vërtetuar se ka uzurpim në mënyrë arbitrare në token në pronësi shoqërore të komunës sëPodujevës në pjesën e njësisë kadastrale P-71712047-00597-1- ZK LL., sipas certifikatës mbi të drejtën e paluajtshme m nr. 17-5818, respektivisht të pjesës se saj ne sipërfaqe prej 323 m2 si dhe është urdhëruar që njëheritt'a liroj pjesën e uzurpuar të pronës shoqërore, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Për me tepër, kjo çështje është vërtetuar edhe me certifikatën e cila gjendet në shkresat e lëndës me nr 17-5818 me numër të njësisë kadastrale P-71712047-00597-1- ZK LL. - me të cilën evidentohet se toka e lartcekur është në pronësi shoqërore në emër të komunës së Podujevës.Andaj, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do të dëshmonte pronësinë mbi këtë pjesë të pronës kontestuese.

Mbi këto arsye gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues i të padituräs Agjencia Kadastrale e Kosovës, Prishtinë, me numër 03/3/639/17 të datës 18.04.2017, si dhe aktvendimi ë shkallë të parë, numër 08-466-4 i datës 06.03.2017, i lëshuar nga Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë KK Podujevë, janë të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njejtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe nga ana e organit të shkallës së parë, si dhe në kundërshtim edhe me provat në lartë cituara.

Sipas nenit 56 të Ligjit për procedurën Administrative është e paraparë se "barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi palët e interesuara në procedimin administrativ, pavarësisht nga detyrimi i administratës për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj".

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar ndaj aktvendimit të organit të shkallës së parë. Mbi

këto arsye, thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.768/17- data 04.02.2020

Zyrtare ligjore — G j y q t a re
Besë Sylaj — Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.